

VENDIM
Nr. 367, datë 6.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 202, DATË 4.3.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE QË RIMBURSOHEN NGA
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE TË
MASËS SË MBULIMIT TË ÇMIMIT
TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, dhe të neneve 6, pika 2, shkronja “b”, e 10, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listat bashkëlidhur vendimit nr. 202, datë 4.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen, përkatësisht, këto ndryshime:

a) Në listën nr. 1, “Lista e barnave që tregtohen në farmacitë e spitaleve 2015”, në grupin L04, imunosupresivët, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- Bari me kod 214/308, *ciclosporin* 25mg *capsul*, hiqet;
- Bari me kod 215/308, *ciclosporin* 100mg *capsul*, hiqet.

b) Në listën nr. 2, “Lista e barnave të rimbursuara 2015”, bëhen këto ndryshime:

i) Në grupin C08, kalçiblokuesit, bari me kod 74/197, *amlodipine* 5mg tablet, hiqet;

ii) Në grupin J01, antibakterialët sistemikë, hiqen:

- bari me kod 360/197, *clarithromycine* 250mg tablet;
- bari me kod 361/197, *clarithromycine* 500mg tablet.

iii) Në grupin L02, barnat në terapinë endokrine, bari me kod 580/105, *bicalutamide* 50mg tablet, hiqet;

iv.) Në grupin S01, barnat *ophthalmike*, bari me kod 525/200, *tobramycine* 3mg/ml-5ml pika, hiqet.

c) Në nënndarjet, që i takojnë grupeve L04, C08, J01, L02 dhe S01, bëhen ndryshimet, sipas tabelës I që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA I
BARNAT E RIMBURSUARA QË TREGTOHEN NË FARMACITË E SPITALEVE 2015

L04 IMUNOSUPRESIVËT

Kodi Barit	Kodi ATC	Emërtimi kimik	Forma	Emri tregtar	Firma	Çmimi referencë	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
214/92	L04AD01	Ciclosporin 25 mg	caps.	Sandimmun Neoral	NOVARTIS	58.10	0.00	58.10
215/92	L04AD01	Ciclosporin 100 mg	caps.	Sandimmun Neoral	NOVARTIS	197.50	0.00	197.50

Barnat e rimbursuara 2015

Kodi Barit	Kodi ATC	Emërtimi kimik	Forma	Emri Tregtar	Firma	Çmimi Referencë	Çmimi Pacientit	Rimbursimi
------------	----------	----------------	-------	--------------	-------	-----------------	-----------------	------------

C08 CALCIBLOKUESIT

74/6	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Amlodipin Alkaloid	ALKALOID	2.50	0.50	2.00
74/73	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Tenox	KRKA	3.20	1.20	2.00
74/200	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Amlodipin Actavis	ACTAVIS	4.90	2.90	2.00
74/226	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Amlodipin Genericon	GENERICON PHARMA	7.50	5.50	2.00
74/79	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Amlopin	LEK	9.00	7.00	2.00
74/237	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Amlodipin Sandoz	SANDOZ	9.40	7.40	2.00
74/96	C08CA01	Amlodipine 5 mg	tabl.	Norvasc	PFIZER	15.30	13.30	2.00

J01 ANTIBAKTERIALËT SISTEMIKË

360/79	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.tabl.	Lekoklar	LEK	30.10	10.50	19.60
360/73	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.tabl.	Fromilid	KRKA	30.10	10.50	19.60
360/2	J01FA09	Clarithromycine 250 mg	f.c.tabl.	Cleron 250	AEGIS	44.70	25.10	19.60

361/107	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Ezumycin	RAFARM	48.10	16.80	31.30
361/79	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Lekoklar	LEK	53.30	22.00	31.30
361/73	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Fromilid	KRKA	53.30	22.00	31.30
361/332	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Eliben	BENNETT PHARMACEUTICALS SA	62.30	31.00	31.30
361/163	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Clabel	NOBEL ILAÇ	66.80	35.50	31.30
361/73a	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	tabl.	Fromilid Uno	KRKA	70.30	39.00	31.30
361/2	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Cleron 500	AEGIS	74.80	43.50	31.30
361/159	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Claripen	ELPEN	77.30	46.00	31.30
361/216	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Claricide	BILIM ILAC SANAYII TICARED	80.30	49.00	31.30
361/121	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Clamodin	SO. SE PHARM	87.70	56.40	31.30
361/7	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.	Maxilin	ANFARM HELLAS	102.50	71.20	31.30
361/181	J01FA09	Clarithromycine 500 mg	tabl.	Klacid LA	ABBOTT	133.60	102.30	31.30

L02 BARNA NË TERAPINË ENDOKRINE

580/267	L02BB03	Bicalutamide 50mg	f.c.tabl.	Bicamide	GENEPHARM SA	119.90	0.00	119.90
580/196	L02BB03	Bicalutamide 50mg	f.c.tabl.	Casodex	ASTRAZENECA	149.90	30.00	119.90

S01 BARNAT OPHTALMIKE

525/3	S01AA12	Tobramycine 3 mg/ml - 5 ml	pika për sy	Tobrex	ALCON	228.20	91.30	136.90
-------	---------	----------------------------	-------------	--------	-------	--------	-------	--------